

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti për krime të rënda, kryetarja e trupit – gjyqtarja Ajser Skenderi me anëtarët e trupit – gjyqtarët: Kymete Kicaj dhe Luan Berisha, me procesmbajtësen Sheqere Braha, në çështjen penale kundër të akuzuarit Xh.H. nga , për shkak të veprës penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par.1.nën par.1.6.dhe 1.5. të KP dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KP, duke vendosur sipas aktakuzës së PSH në Prizren PPI./nr.21/16 të datës 31.08.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prezencën e Prokurorit të Mehdi Sefa, përfaqësuesit të palës së dëmtuar avokat A.B., të akuzuarit dhe mbrojtëses së tij avokate E.Gj., më datën 28.04.2017, muarr dhe publikisht e shpalli këtë

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

XH.H. , nga i ati Sh. dhe e ëma F. – e lindur M., i lindur më “i lindur me ...” në , me banim në në rrugën “..... ..”, e ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar Shtetas i Republikës së Kosovës, gjindet në paraburgim prej datës 05.02.2016.

ËSHTË FAJTOR

1.Se më datën 27.01.2016 rrethë orës 19:00 në fshatin Komuna e Suharekës me dashje privon nga jeta E.M. dhe e vënë në rrezik jetën e N.M.1, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore, në atë mënyrë që i akuzuari N.M. me automjetin e tipit “..... ..” me nr. të rregjistrimit .. - ... - .. të cilin e merr me rent-car nga firma “.....” me seli në , së bashku me të akuzuarin Xh.H. shkojnë në fshatin në shtëpinë e N. M.1 me qëllim për të vjedhur me ç rast i akuzuari N.M. pret në automjet duke bërë roje ndërsa i akuzuari Xh.H. hynë në shtëpi dhe pasi hetohet nga pronari N.M.1, e nxjerr pistoletën nga një afërsi, shtënë dhe e plagosë në të dy këmbët N.M.1 duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore, plagë nga arma e zjarrit në nëngjurin e majtë, në regjionin e nënkofshës së djathtë si dhe regjionin gluteal të djathtë pa dalje, të shkaktuar nga veprimi dinamik i predhave të hedhura nga arma e zjarrit, ndërsa me një predhë e qëllon në pjesën e gjoksit në anën e majtë djalin e N.M.1, E.M. i cili nga plagët që janë shkaktuar nga

arma e zjarrit ndëron jetë si rrjedhojë e gjakderdhjes së brendshme dhe të jashtme nga dëmtimi i mushkrisë së majtë, zemrës dhe aortës, si pasojë e veprimit dinamik të predhës së hedhur nga arma e zjarrit dhe dërgohet pa shenja jete në Qendrën e mjekësisë familjare në Suharekë dhe pas veprës së kryer të akuzuarit me automjetin i cili drejtohej nga i akuzuari N.M. arratisen në drejtim të fshatit të Komunës së Lipjanit.

Këso dore ka kryer veprën penale vrasje e rëndë nga neni 179 par.1.nën par.1.6.dhe 1.5. të KP.

2.Se më datën, kohën dhe vendin e njejtë si në dispozitivin nën l/ mban në posedim pistoletën e prodhimit “Crvena Zastava “ të kal.7.65 mm, MOD 70 me nr.serik 599ll pa leje valide nga ana e organit kompetent duke e shkelur Ligjin e zbatueshëm për armët.

Keso dore ka kryer veprën penale mbajtja ne pronesi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 te KP.

Andaj, gjykata konformë dispozitave të nenit 4, 7, 17, 41, 43, 45, 62 par.2 pika 2.6, 73, 80, 83 lidhur me nenin 179 par.1.nën par.1.6.dhe 1.5.si dhe nenit 374 par.1.të KP, e

G J Y K O N

Për veprën penale vrasje e rëndë nga neni 179 par.1. nën par.1.6.dhe 1.5. të KP, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **23 /njëzettri/ viteve.**

Për veprën penale mbajtja ne pronesi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KP me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **1 /një/ viti.**

Andaj, gjykata konforme dispozitave te nenit 80 par.2 pika.2.2 te KP për veprat e lartëcekura penale të akuzuarit ia shqipton **dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 23 vite e 6 muaj,** në të cilin dënim me burgim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 05.02.2016 gjerë në plotëfuqishmërinë e aktgjykimit.

Të dëmtuarit N.M.1 , D.M. dhe E.M. për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohen në kontest të rregulltë civil.

Nga i akuzuari Xh.H. konfiskohet pistoleta e prodhimit “Crvena Zastava” e kal.7.65 mm, MOD 70 me nr.serik 599ll si mjet i kryerjes së veprës penale.

Obligohet i akuzuari Xh.H. që në emër të paushalit gjyqësor ta paguajë shumën prej 200 Euro në afat prej 15 ditëve pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria e Shtetit në Prizren kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP.nr.I/21/16 të datës 31.08.2016, kundër të akuzuarëve Xh.H. për shkak të veprës penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par.1.nën par.1.6.dhe 1.5. të KP dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KP, si dhe të akuzuarit N.M. për shkak të veprës penale vrasje e rëndë në ndihmë nga neni 179 par.1.nën par.1.6.dhe 1.5. lidhur me nenin 33 të KP.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 02.02.2017 i akuzuari Xh.H. e ka pranuar fajsinë për veprën penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par.1.nën par.1.6.dhe 1.5. të KP dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KP dhe se konformë nenit 326 par.5. të KPP është vazhduar shqyrtimi me të akuzuarin e dytë N.M. , ndërsa shqiptimi i dënimit për të akuzuarin Xh.H. është shtyrë deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor.

Në ndërkohë më datën 03.04.2017 Shërbimi korrektues i Kosovës-Qendra e paraburgimit në Lipjan me shkresë e ka njoftuar gjykatën se i paraburgosuri N.M. i cili gjendej në paraburgim nga data 03.02.2016 ka ndëruar jetë.Kësaj shkrese ia kanë bashkangjitur edhe raportin mjekësor të Qendrës mjekësore të mjekësisë familjare të Qendës emergjente në Lipjan me nr.282 të datës 03.04.2017 ku është konstatuar se i akuzuari ka ndëruar jetë.

Në bazë të këtyre raporteve Kryetarja e trupit gjykues më datën 04.04.2017 ka marrë aktvendim mbi pushimin e procedurës penale për shkak të vdekjes dhe hudhjen e aktakuzës sa i përket të akuzuarit N.M. , për shkak të veprës penale vrasje e rëndë në ndihmë nga neni 179 par.1.nën par.1.6.dhe 1.5. lidhur me nenin 33 të KP.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 28.04.2017,në fjalën përfundimtare, prokurori i shtetit Mehdi Sefa ka ngelë në tërësi pranë aktakuzës duke cekur se me vet panimin e fajsisë dhe provave pamëdyshje është vërtetuar gjendja faktike si nën dispozitivin nën 1/ dhe 2/ të akuzës, se këtu i akuzuari më datën 27.01.2016 me dashje ka privuar nga jeta E.M. dhe ka shkaktuar lëndime të rënda trupore N.M.1 me çka edhe formohen elementet e veprës penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par.1. nën par.1.6. dhe 1.5. të KP. Andaj, ka kërkuar që gjykata të akuzuarin ta shpall fajtor për dy veprat e lartëcekura penale dhe se me rastin e shqiptimit të dënimit ti ketë parasysht rrethanat rënduese, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj vepre penale dhe vlerat të cilat duhen të mbrohen me një vendim adekuat dhe proporcional me peshën e veprës penale e ajo është jeta dhe trupi i njeriut.Ka kërkuar që dënimi të jetë adekuat dhe që sadopak pikëllimi i familjes M. të zvogëlohet. Si dënim plotësues ka propozuar konfiskimin e armës si mjet i kryerjes së veprës penale.

Përfaqësuesi i palëve të dëmtuara avokat A.B. e ka mbështetur fjalën përfundimtare të prokurorit,duke shtuar se edhe pse i akuzuari e ka pranuar veprën penale

ka propozuar gjykatës që këtë pranim mos ta merr si rrethanë lehtësuese gjatë matjes dhe shqiptimit të dënimit pasiqë i akuzuari ka kryer një vepër shumë të rëndë. Poashtu ka ngelë në tërësi pranë kërkesës pasuroro-juridike.

Të dëmtuarit N.M.1 , D.M. dhe E.M. janë pajtuar me fjalën përfundimtare të dhënë nga ana e Prokurorit të shtetit dhe përfaqësuesit të tyre dhe se kanë parashtruar kërkesë pasuroro-juridike për lartësinë e së cilës do të deklarohen në kontest të rregulltë civil.

Mbrojtësja e të akuzuarit Xh.H. avokate E.Gj. ka deklaruar se pasiqë i mbrojturi i saj e ka pranuar fajsinë me vullnetin e tij, i njëjti është i vetëdijshëm se ky pranim nuk e liron nga përgjegjësia, ka propozuar që gjykata me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ti ketë parasysh rrethanat lehtësuese, posaqërisht pranimin e fajsisë, qëndrimin korrekt, rrethanat personale dhe familjare, se është i pa arsimuar, i gjendjes së varfër ekonomike, i pa punë, i moshës së re, pendohet sinqerisht për atë që ka bërë dhe kërkon falje prej familjarëve të të ndjerit E.M. .

I akuzuari Xh.H. është pajtuar me pohimet e mbrojtëses duke theksuar se i vjen keq për atë që ka ndodhur, është penduar, ka kërkuar falje familjes së të dëmtuarit dhe se pajtohet me çfarëdo dënimi të dhënë nga gjykata pasiqë ka bërë një vepër shumë të rëndë, ka kuptuar çka ka bërë dhe është penduar thellë për këtë vepër.

Duke marrë parasysh të lartëcekurat – pranimin e fajsisë së të akuzuarit Xh.H. gjykata edhe ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par.1.nën par.1.6 dhe 1.5. të KP, pasiqë më datën 27.01.2016 rrethë orës 19:00 në fshatin Komuna e Suharekës me dashje privon nga jeta E.M. dhe e vënë në rrezik jetën e N.M.1 , me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore, në atë mënyrë që i akuzuari N.M. me automjetin e tipit “.....” me nr. të rregjistrimit .. - ... - .. të cilin e merr me rent-car nga firma “.....” me seli në , së bashku me të akuzuarin Xh.H. shkojnë në fshatin në shtëpinë e N.M. me qëllim për të vjedhur me ç rast i akuzuari N.M. pret në automjet duke bërë roje ndërsa i akuzuari Xh.H. hynë në shtëpi dhe pasi hetohet nga pronari N.M.1 , e nxjerr pistoletën nga një afërsi, shtënë dhe e plagosë në të dy këmbët N.M.1 duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore, plagë nga arma e zjarrit në nëngjurin e majtë, në regjionin e nënkofshës së djathtë si dhe regjionin gluteal të djathtë pa dalje, të shkaktuar nga veprimi dinamik i predhave të hedhura nga arma e zjarrit, ndërsa me një predhë e qëllon në pjesën e gjoksit në anën e majtë djalin e N.M.1 , E.M. i cili nga plagët që janë shkaktuar nga arma e zjarrit ndëron jetë si rrjedhojë e gjakderdhjes së brendshme dhe të jashtme nga dëmtimi i mushkrisë së majtë, zembrës dhe aortës, si pasojë e veprimit dinamik të predhës së hedhur nga arma e zjarrit dhe dërgohet pa shenja jete në Qendrën e mjekësisë familjare në Suharekë dhe pas veprës së kryer të akuzuarit me automjetin i cili drejtohej nga i akuzuari N.M. arratisen në drejtim të fshatit të Komunës së Lipjanit.

Poashtu në bazë të pranimin të fajësisë gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit Xh.H. formohen elementet qenësore të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KP, pasiqë me datë, kohë dhe vend të njëjtë si në dispozitivin nën 1/, të këtij aktgjykimi mbanë në posedim

pistoletën e prodhimit “Crvena Zastava “ të kal.7.65 mm, MOD 70 me nr.serik 599ll pa leje valide nga ana e organit kompetent duke e shkelur Ligjin e zbatueshëm për armët.

Gjykata e ka aprovuar pranimin e fajsisë së të akuzuarit Xh.H. për të dy veprat e lartëcekura penale, pasi që pranimi i fajsisë është bërë konforme nenit 326 lidhur me nenin 248 të KPP, i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë, pranimi i fajsisë është bërë vullnetarisht pas konsultimit me mbrojtësen e tij, pranimi i fajsisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, bazuar në të lartëcekurat gjykata edhe e shpalli fajtor të akuzuarin Xh. H. për veprën penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par.1.nën par.1.6.dhe 1.5. të KP dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KP dhe se për secilën nga këto vepra penale ia shqiptoi dënimin me burgim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe se me aplikimin e dispozitave për dënimin unik të akuzuarit ia shqiptoi dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 23 vite e 6 muaj.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin konformë nenit 73 të KP, përkitazi me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në të njëjtën duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rritjen e dënimit, shkallën e përgjegjësisë, motivet nga të cilat është kryer vepra, prej rrethanave lehtësuese morri parasysh qëndrimin e tij korrektë, pranimin e fajsisë për dy veprat penale, moshën relativisht të re dhe pendimin për kryerjen e veprës penale. Ndërsa prej rrethanave rënduese peshën dhe natyrën e veprave penale-kemi të bëjmë me veprën penale të drejtuar kundër jetës së njerëzve-vlera të shoqërisë të cilat janë të mbrojtura me ligj, mënyrën e kryerjes-i akuzuari i armatosur ka hyrë në shtëpinë e të dëmtuarve i armatosur me armë dhe ka gjuajtur në drejtim të dëmtuarëve të cilët kanë qenë duarthatë pa kurrfarë mjeti apo arme në dorë, pasojat e veprës penale-të cilat kanë qenë fatale për të dëmtuarin E.M. i cili ka qenë i moshës së re. Andaj, është mendimi i gjykatës që dënimi i shqiptuar do ta arrij qëllimin e vet konformë nenit 41 të KP, se dënimi i shqiptuar është në harmoni me intenzitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se do të mundësoj një balans të drejtë në mes të kërkesave që të akuzuarit ti mundësohet risocializimi dhe kërkesës së shoqërisë që ai dënim me peshën e tij të ketë karakter të përgjithshëm parandalues nga kryerja e veprave penale. Gjykata është e mendimit se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në shërbim të preventivës së përgjithshme, posaqërisht të asaj të posaçme, se do të ndikoj në forcimin e moralit të shoqërisë, përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KP në të gjitha segmentet e tij. Dënimet e shqiptuara për kah lloji dhe lartësia janë në harmoni me rrethanat e rastit, të nevojshme dhe të mjaftueshme për tu arritur qëllimi i dënimit konform dispozitës së lartëcekur. Dënimi i shqiptuar të akuzuarit sipas gjetjes së gjykatës është në harmoni dhe në baraspeshë me peshën e veprës së kryer penale dhe se kur të mirret parasysh shkalla e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, mënyra dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, fakti se është kryer njëra prej veprave më të rënda penale, në atë situatë edhe nuk ka patur vend që gjykata të shqiptoj dënim më të butë. Dënimet e këtilla

paraqiten si të domosdoshme me qëllim të arritjes së qëllimit të dënimit, me to shprehet gjykimi i shoqërisë për shkak të veprës së kryer penale dhe forcohet obligimi i respektimit të ligjit.

Nga të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimi mbi kërkesën pasuroro-juridike është marrë konformë nenit 463 par.2 të KPP.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konformë nenit 450 par.2 pika 2. 6 në lidhje me nenin 453 par.1. të KPP.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti për krime të rënda
Më dt. 28.04.2017.P.nr.137/16

Proçesmbajtësja
Sheqere Braha

Kyetarja e trupit gjykues
Ajser Skenderi

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, **Gjykatës së Apelit në Prishtinë**, nëpërmjet të kësaj gjykate.